




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna nga neni 63.4, neni 15.5 dhe nenit 26 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenit 4 të Rregullës Zgjedhore nr.08/2013 për Certifikim të Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të Zyrës Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 28.08.2021 merr këtë:



V E N D I M

- I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për certifikimin e partisë politike **"Partia e Drejtësisë" (PD)**, dhe listës prej 5 (pesë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Gjakovës, listës prej 13 (trembëdhjetë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Gjilanit, listës prej 6 (gjashtë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Fushë Kosovës, listës prej 18 (tetëmbëdhjetë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Mitrovicës së Jugut, dhe listës prej 33 (tridhjetë e tre) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Podujevës, për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.
- II. Ky subjekt politik certifikohet për të marrë pjesë në zgjedhjet për Kuvend Komunal në Komunën e Gjakovës, Gjilanit, Fushë Kosovës, Mitrovicë së Jugut, Podujevës.
- III. Zyra obligohet që të njoftoj partinë politike **Partia e Drejtësisë (PD)**, për marrjen e këtij Vendimi.
- IV. Subjekti politik i certifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar KQZ-së një njoftim me shkrim në të cilin shpreh qartazi qëllimin për tërheqje, jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit për radhitjen në fletëvotim.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi



Këshillë juridike: Brenda 24 orëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, të gjithë personat që kanë interes ligjor kanë të drejtë ankese në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës – PZAP.